



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

№ 1851 Prot

Tiranë, më 27.5:2017

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

- Përgjegjës i Zyrës së Akcizës, në Degën Doganore Korçë, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vend)
- Përgjegjës i Zyrës së Akcizës, në Degën Doganore Vlorë, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vend)
- Përgjegjës i Zyrës së Akcizës, në Degën Doganore Fier, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vend)

**Përshkrim përgjithësues për pozicionin:**

- Garanton koordinimin e përgjithshëm të veprimeve doganore me qëllim realizimin e objektivave operacionale.
- Merr raportime (feedback) mbi ecurinë e punës nga vartësit.
- Zgjidh rastet apo problemet e ngritura nga doganieret e zyrës së akcizës.
- Mbështet dhe kujdeset për rritjen e aftësive teknike dhe profesionale të stafit në varësi.
- Kujdeset për kushtet e punës së stafit me qëllim rritjen e efikasitetit.

- 
- Raporton tek Kryetari i Doganës performancën dhe arritjet e lidhura me objektivat operacionale.
  - Mbledh sugjerime apo propozime në lidhje me përmirësimin e punës.
  - Propozon përmirësime në lidhje me procedurat, formalitetet doganore, analizat e riskut apo kontrollet paszhdoganimit.
- 

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

**Kriteret minimale:**

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

**Kriteret e veçanta:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, shoqërore, politike etj.
- Të ketë mbi 2 vjet eksperiencë pune në nivel ekzekutiv në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 06.10.2017 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

---

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)".

---

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda Ikonomi**

